

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar–tetor 2021
- Ecuria e tregut të Fondeve të Investimeve, 30.09.2021
- Ecuria e tregut të Pensioneve Private Vullnetare, 30.09.2021

Zhvillime të tjera

- Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së merr pjesë në prezantimin e platformës për shërbimet e investimit *online* të BKT-së
- AMF nxjerr për konsultim publik:
 - Projektligjin “Për fondet e pensionit privat”;
 - Projektregulloren “Për përcaktimin e elementëve të përlogaritjes dhe nivelet e tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura”;
 - Grupin e dytë të projektregulloreve në zbatim të Ligjit nr. 66/2020;
 - Projektregulloren “Për formën dhe përmbajtjen e prospektit që publikohet kur titujt i ofrohen publikut dhe pranohen për tregtim në një treg të rregulluar”

Publikime Profesionale

- IAIS – Raporti i tregut global të sigurimeve ofron studimin e parë sasior mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike në investimet e siguruesve
- “Global Risk Regulator”
 - SEC u jep dritë jeshile *Future ETF* të lidhura me Bitcoin
 - Disa monedha virtuale të qëndrueshme, *stablecoins*, mund të etiketohen me rëndësi sistemike
 - Konferenca e COP26 i jep një nxitje të mëtejshme financimit të ndryshimeve të klimës

Informacione Ndërkombëtare

- Bosnje-Hercegovinë
- Bullgari
- Greqi
- Kosovë
- Turqi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar–tetor 2021


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-tetor 2021 kapën vlerën 15,741 milionë lekë, ose 16.48% më shumë se në janar-tetor 2020. Gjatë periudhës janar-tetor 2021, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 952,992 me një rritje prej 21.34% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.56% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 7.28%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 38.91% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 61.09% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-tetor 2021, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 5,591 milionë lekë, ose 9.71% më pak se në periudhën janar-tetor 2020, ndikuar kryesisht nga pagesa e pjesës më të madhe të dëmshpërblimeve për tërmetet e fundvitit 2019 gjatë vitit të kaluar.

Ndërkohë dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar-tetor 2021 kapën vlerën 3,333 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 31.67% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar-tetor 2021 (Në %)



Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar–tetor 2021 u rritën me rreth 31.67% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Ecuria e tregut të Fondeve të Investimeve, 30.09.2021


Gjatë periudhës 30.09.2021, në tregun e fondeve të investimeve ushtruan aktivitetin e tyre nëntë fonde investimi. Fondi i investimeve “Raiffeisen Prestigj”, “Raiffeisen Invest Euro”, “Raiffeisen Vizion” dhe “Raiffeisen Mix” të administruara nga shoqëria “Raiffeisen Invest”, fondi i investimeve “Credins Premium” nën administrimin e shoqërisë administruese “Credins Invest”, fondi “WVP Top Invest” dhe fondi “WVP GLOBAL” administrohet nga shoqëria “WVP Fund Management Tirana sh.a”, fondi i investimeve “Albsig Standard” nën administrimin e shoqërisë administruese “Albsig Invest”sh.a, fondi “ABI EIA” administrohet nga shoqëria “ABI Invest”.

Sipas analizës së të dhënave për tregun e fondeve të investimeve në 30.09.2021, vlera neto e aseteve të fondeve, arriti rreth 75.15 miliardë lekë me një rritje prej 7,742 milionë lekë ose 11.49%, krahasuar me 31.12.2020.

Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në Obligacione Qeveritare, të cilat përbëjnë 64.67% të aseteve të fondeve, me një rritje prej 5.59% krahasuar me 31.12.2020.

Numri i anëtarëve që kanë investuar në Fondet e Investimit më 30.09.2021 është 38,015 me një rritje prej 16.41% krahasuar me 31.12.2020.

Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të investimeve më 30.09.2021 (Në %)




Sipas analizës së të dhënave për tregun e fondeve të investimeve në 30.09.2021, vlera neto e aseteve të fondeve, arriti rreth 75.15 miliardë lekë me një rritje prej 7,742 milionë lekë ose 11.49%, krahasuar me 31.12.2020.

Ecuria e tregut të Pensioneve Private Vullnetare, 30.09.2021


Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2021, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre katër fonde pensioni. Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 30.09.2021 tregon një total asetesh neto prej 4,284.84 milionë lekë ose rreth 35.25 milionë euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë 1 euro = 121.54 lekë. Ky total asetesh shënon një rritje prej 681.56 milionë lekë ose rreth 18.92% krahasuar me fundin e vitit 2020.

Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve, më 30.09.2021 rezultoi 32,932 anëtarë, duke shënuar një rritje prej 6.16% krahasuar me 31.12.2020.

Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensioneve vullnetare, 30.09.2021 (Në %)



Ndarja e tregut sipas vlerës neto të aseteve në fondet e pensioneve vullnetare, 30.09.2021 (Në %)



ZHVILLIME TË TJERA

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së merr pjesë në prezantimin e platformës për shërbimet e investimit *online* të BKT-së



11 nëntor 2021 – Z. Ervin Mete, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në prezantimin e platformës për kryerjen e shërbimeve të investimit online nga BKT


Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, me Vendimin nr. 193, datë 26.10.2021, i dha të drejtën shoqërisë “Banka Kombëtare Tregtare” sh.a. për kryerjen e shërbimeve të investimit *online*, nëpërmjet platformës “Smart Invest”.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, z. Ervin Mete mori pjesë në ceremoninë e prezantimit nga Banka Kombëtare Tregtare (BKT) të platformës për kryerjen e shërbimeve të investimit *online*, në partneritet me bankën e specializuar evropiane Saxo Bank. Në fjalën e mbajtur në këtë aktivitet, z. Mete theksoi se AMF është angazhuar në përafrimin e kuadrit ligjor e rregullator me legjislacionin e BE-së, gjë që ka krijuar edhe mundësi të reja të ndërlidhjes me tregjet financiare ndërkombëtare.

Ligjet e reja kanë rritur standardet dhe kërkesat për transparencë dhe përshtatshmëri, si elementë thelbësorë të nxitjes së besimit dhe pjesëmarrjes së investitorëve në tregjet e kapitalit. Kjo është platforma e parë e shërbimeve të investimeve *online*, që i jep akses të drejtpërdrejtë investitorëve shqiptarë, duke i ofruar mundësinë e investimit në aksione të kompanive ndërkombëtare dhe në një sërë instrumentesh të tjera financiare, u shpreh Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së.

Duke marrë në konsideratë se investimi në instrumente financiare shoqërohet edhe me rreziqe, Autoriteti ka ndërmarrë një ndërhyrje strikte rregullatore, duke vendosur kritere shtesë lidhur me vlerësimin e përshtatshmërisë së klientit, rritjen e nivelit të transparencës, si edhe efektivitetin dhe sigurinë e sistemit përmes të cilit ofrohet shërbimi *online* në investime.

Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, me Vendimin nr. 193, datë 26.10.2021, i dha të drejtën shoqërisë “Banka Kombëtare Tregtare” sh.a. për kryerjen e shërbimeve të investimit *online*, nëpërmjet platformës “Smart Invest”.



Faqe Kryesore ▸ Legjislatiioni ▸ Projektakte ▸ Projektligje

Projektligji "Për fondet e pensionit privat"

AMF nxjerr për konsultim publik:

▪ Projektligjin "Për fondet e pensionit privat"

Projektligji "Për fondet e pensionit privat" është publikuar për konsultim në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike. Projektligji, i hartuar në përputhje me Direktivën 2016/2341/KE "Për veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e Institucioneve të Pensionit Profesional" (IORP II), gjendet gjithashtu në faqen zyrtare të AMF-së, në linkun <https://amf.gov.al/projekt.asp?id=80>

Projektligji "Për fondet e pensionit privat" rregullon:

- Licencimin dhe veprimtarinë e shoqërive administruese të fondeve të pensionit privat në Republikën e Shqipërisë;
- Krijimin dhe veprimtarinë e fondeve të pensionit privat me kontribute të përcaktuara në Republikën e Shqipërisë;
- Licencimin dhe veprimtarinë e depozitarit të aseteve të fondit të pensionit privat;
- Mbikëqyrjen e shoqërive administruese të fondit të pensionit privat, të depozitarit të aseteve të fondit të pensionit dhe të subjekteve të tjerë sipas këtij ligji;
- Veprimtarinë ndërkufitare të shoqërive administruese që ofrojnë fonde të pensionit privat me pjesëmarrje të mbyllur.

▪ Projektregulloren "Për përcaktimin e elementëve të përlllogaritjes dhe nivelet e tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura"

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, mbështetur në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar, ka realizuar disa ndryshime në Rregulloren nr. 155, datë 23.12.2014 "Për përcaktimin e elementëve të përlllogaritjes dhe nivelet e tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura, si dhe procedurat e arkëtimit dhe rakordimit të tyre", e ndryshuar. Dokumenti publikohet në faqen zyrtare të AMF-së, në linkun <https://amf.gov.al/projekt.asp?id=77>

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i elementëve të përlllogaritjes dhe nivelet e tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura nga Autoriteti, si dhe procedurat e arkëtimit dhe rakordimit të tyre.

Aktet për konsultim publik gjenden në:

<https://amf.gov.al/projekt.asp?id=80>

<https://amf.gov.al/projekt.asp?id=77>



Faqe Kryesore » Legjislati » Projektakte » Projektregullore

Projektregullore "Për formën dhe përmbajtjen e prospektit që publikohet kur titujt i ofrohen publikut dhe pranohen për tregtim në një treg të rregulluar"

Projektregullore "Për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si Bursë DLT"

Projektregullore "Për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si kujdestar të portofolit të palëve të treta"

Projektregullore "Për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si agjent i tokenit digital"

Projektregullore "Për njahshëmërinë e kapitalit dhe fondet e veta të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë në tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistruar të sipërndarës"

AMF nxjerr për konsultim publik:

▪ Grupin e dytë të projektregulloreve në zbatim të Ligjit nr. 66/2020

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka hartuar grupin e dytë të projektregulloreve në zbatim të Ligjit nr. 66/2020 "Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistruar të shpërndarë". Aktet janë hartuar mbështetur në projektregulloren nr. 648/2012 të Parlamentit dhe Këshillit Europian "On Markets in Crypto-assets, and amending Directive (EU) 2019/1937".

Dokumentet që publikohen në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, janë:

- [Projektregullore "Për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si kujdestar të portofolit të palëve të treta"](#)
- [Projektregullore "Për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si Bursë DLT"](#)

▪ Projektregulloren "Për formën dhe përmbajtjen e prospektit që publikohet kur titujt i ofrohen publikut dhe pranohen për tregtim në një treg të rregulluar"

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 62/2020 "Për Tregjet e Kapitalit", ka hartuar projektregulloren "Për formën dhe përmbajtjen e prospektit që publikohet kur titujt i ofrohen publikut dhe pranohen për tregtim në një treg të rregulluar".

Projektregullorja publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun: <https://amf.gov.al/projekt.asp?id=81>

Aktet për konsultim publik gjendet në:

[Projektregullore "Për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si kujdestar të portofolit të palëve të treta"](#)

[Projektregullore "Për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si Bursë DLT"](#)

<https://amf.gov.al/projekt.asp?id=81>



Raporti i Tregut Global të Sigurimeve - IAIS - ofron studimin e parë sasior mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike në investimet e siguruesve

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) publikoi edicionin e posaçëm për vitin 2021 të Raportit të Tregut Global të Sigurimeve (GIMAR). Raporti, një studim i parë i tillë sasior global, vlerëson se si investimet e sektorit të sigurimeve janë të ekspozuara ndaj ndryshimeve klimatike.

“Ndryshimet klimatike janë sfida përcaktuese për këtë brez. GIMAR përdor të dhëna nga anëtarësimi ynë i gjerë në kombinim me mjete analitike për të kuptuar se si sektori i sigurimeve është i ekspozuar ndaj rrezikut të klimës” tha Vicky Saporta, Kryetare e Komitetit Ekzekutiv të IAIS. “Rezultatet nxjerrin në pah përfitimet e ndjekjes së një tranzicioni të rregullt drejt objektivave klimatike të dakordësuara ndërkombëtarisht për të minimizuar rreziqet ndaj aftësisë paguese dhe stabilitetit financiar.”

Raporti prezanton se më shumë se 35% e aktiveve të investuara të siguruesve janë të ekspozuar ndaj rreziqeve nga ndryshimet klimatike, sipas të dhënave që mbulojnë 75% të sektorit global të sigurimeve.

Analiza e skenarit konfirmon përfitimet e rëndësishme të një tranzicioni të rregullt drejt objektivave klimatike të dakordësuara ndërkombëtarisht nga perspektiva e stabilitetit financiar dhe aftësisë paguese.

Raporti i IAIS ofron perspektivë të rëndësishme mbikëqyrëse të sigurimeve në përpjekjet ndërkombëtare për të identifikuar dhe adresuar boshllëqet e të dhënave dhe për të analizuar rreziqet e stabilitetit financiar.

IAIS - Raporti i Tregut Global të Sigurimeve

<https://www.iaisweb.org/news/iais-publishes-2021-global-insurance-market-report-gimar>



Subjects / Financial Markets

Some stablecoins could be labelled as systemically important

Justin Pugsley | October 14, 2021



Global standard-setters are taking their first steps towards herding stablecoins into the regulatory ambit as their importance continues to grow worldwide, raising concerns about financial stability.

<https://www.globalriskregulator.com/Subjects/Financial-Markets/SEC-gives-green-light-to-bitcoin-futures-ETFs>

<https://www.globalriskregulator.com/Subjects/Financial-Markets/Some-stablecoins-could-be-labelled-as-systemically-important>

1. SEC u jep dritë jeshile Future ETF të lidhura me Bitcoin (SEC gives green light to bitcoin futures ETFs)

Justin Pugsley

Komisioni Amerikan i Titujve (SEC) ka hapur më së fundi dritën jeshile për Fondet e Tregtuara në Këmbim (*Exchange Traded Funds, ETF*) të mbështetur nga Bitcoin. E para prej tyre u lançua në Bursën e Nju Jorkut (NYSE) më 19 tetor dhe u prit me shumë bujë mes entuziastëve të kriptomonedhave.

2. Disa monedha virtuale të qëndrueshme, *stablecoins*, mund të etiketohen me rëndësi sistemike (Some stablecoins could be labelled as systemically important)

Justin Pugsley

Hartuesit globalë të standardeve po ndërmarrin hapat e tyre të parë për përfshirjen dhe drejtimin e monedhave virtuale të qëndrueshme, *stablecoins*, brenda kuadrit dhe sferës rregullatore. Këto lëvizje vijnë pas evidentimit se rëndësia e *stablecoins* vazhdon të rritet në mbarë botën, duke ngritur shqetësime për stabilitetin financiar.



COP26 gives climate finance a further boost

Justin Pugsley | November 18, 2021



The high profile COP26 conference, which ended on November 12, is likely to accelerate the use of climate finance and will see financial regulators act with greater urgency to green the financial system, according to industry sources.

3. Konferenca e COP26 i jep një nxitje të mëtjshme financimit të ndryshimeve të klimës (COP26 gives climate finance a further boost)

Justin Pugsley

Sipas burimeve të industrisë financiare, konferenca e nivelit të lartë, COP26, e cila përfundoi më 12 nëntor, duket se do të përshejtojë përdorimin e financave për çështjet e klimës. Ajo do të bëjë që rregullatorët financiarë të veprojnë me urgjencë më të madhe për të gjelbëruar sistemin financiar, (to green the financial system) pra për të mobilizuar sistemin financiar drejt zhvillimit të mjedisit dhe menaxhimit të rreziqeve klimatike dhe kalimit drejt një ekonomie të qëndrueshme.

BOSNJE-HERCEGOVINË

www.xprimm.com

Sipas të dhënave më të fundit të tregut të publikuara nga Agjencia e Sigurimeve të Bosnjës dhe Hercegovinës, AZO BiH, siguruesit në vend, në fund të tremujorit të tretë realizuan një vëllim të primeve të shkruara bruto prej 618 milionë BAM, rreth 316 milionë euro, duke shënuar rritje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Sektori i sigurimeve të Jo-Jetës zinte rreth 79.6% të primeve të shkruara bruto, me rreth 492 milionë BAM ose 7.7% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Ndërsa sigurimet e Jetës realizuan një vlerë prej 126 milionë BAM, ose 12.3% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Siguruesit e Federatës së BiH kanë siguruar pothuajse 70% të primeve të shkruara bruto, ndërsa siguruesit në Republikën Serbe të Bosnjës realizuan pjesën tjetër prej 30 % të primeve të shkruara bruto ose 186 milionë BAM.

BULLGARI

www.fsc.bg

Sipas të dhënave të publikuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Bullgarisë, për periudhën janar-gusht 2021, vëllimi i primeve të shkruara bruto në tregun bullgar të sigurimeve arriti mbi 1.1 miliardë euro.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës për të njëjtën periudhë arriti në 1,776,807,727 BGN ose mbi 908 milionë euro. Ndër klasat e sigurimeve të Jo-Jetës, sigurimi motorik zinte pjesën më të madhe të volumit të primeve të shkruara bruto me 72.2% të totalit dhe sigurimi nga zjarret, forcat e natyrës dhe sigurimi i pronës zinin 12.4%.

Sigurimet e Jetës, në periudhën janar-gusht 2021, realizuan një vëllim të primeve të shkruara bruto prej 397,405,267 BGN ose mbi 203 milionë euro. Në klasat e sigurimit të Jetës, pjesën më të madhe e zinin primet e shkruara bruto të sigurimit të Jetës dhe anuiteteve me 36.8% të totalit, sigurimi i Jetës i lidhur me skemat e investimeve me 40% (*unit link life insurance*), si edhe sigurimi nga aksidentet dhe sëmundjet së bashku me 15.9%.

GREQI

www.xprimm.com

Shifrat paraprake të tregut të sigurimeve për tremujorin e tretë 2021, të publikuara nga Shoqata Helenike e Shoqërive të Sigurimeve, HAIC, tregojnë se në fund të shtatorit 2021, tregu grek i sigurimeve arriti në 3.17 miliardë euro, duke u rritur me 9.3%, e shprehur në terma vjetorë.

Segmenti i sigurimeve të Jo-Jetës u rrit me 5.1%, në terma vjetorë duke arritur në 1.66 miliardë euro. Në këtë volum të primeve të shkruara bruto, linjat kryesore të bizneset ishin: sigurimi MTPL me 531.3 milionë euro prime, dhe sigurimi i pronës dhe pasurisë me 336.9 euro. Ndërsa segmenti i sigurimit të Jetës u rrit me 14.4% duke arritur në 1.50 miliardë euro, e ndikuar kryesisht nga dinamika pozitive e raportuar në produktet e Jetës të lidhura me skemat e sigurimeve, të cilat u rritën me afro 66.4%.

Shifrat e tregut të publikuara nga HAIC përfshijnë informacionin për 50 kompani sigurimesh, nga të cilat 18 ishin aktive në sigurimet e Jetës dhe 45 ishin aktive në sigurimet e Jo-Jetës.

KOSOVË

www.xprimm.com

Sipas publikimeve mujore zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës, BQK, siguruesit kosovarë realizuan një rritje dyshifrore të primeve të shkruara bruto gjatë periudhës janar–shtator 2021.

Primet e shkruara bruto në sigurimet e Jo-Jetës arritën në 84.8 milionë euro, ndërsa primet e sigurimit të Jetës u rritën në 3.5 milionë euro. Në të njëjtën kohë, totali i dëmeve bruto të paguara u rrit me 32%, e shprehur në terma vjetore, duke arritur në 48.7 milionë euro, për shkak të rritjeve të mëdha të raportuara për produktet e MTPL-së së brendshme (rritje 22% e shprehur në terma vjetore) dhe policave kufitare (+178% e shprehur në terma vjetore). Më 30 shtator 2021, vlera e asetet në zotërim nga kompanitë e sigurimit kosovar u rrit, duke arritur në 235.7 milionë euro, nga 214.3 milionë euro që ishte ky tregues një vit më parë.

Sipas BQK, shifrat dhe informacionet i referohen të dhënave për 13 kompani të sigurimit që operojnë në Kosovë, 11 në fushën e sigurimeve të Jo-Jetës dhe dy kompani të sigurimit të Jetës.

TURQI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave paraprake të publikuara nga Shoqata e Sigurimeve të Turqisë, TSB, të ardhurat totale nga primet në tremujorin e tretë 2021 në sektorin turk të sigurimeve u rritën me 19,14% e shprehur në terma vjetorë duke arritur në 70.6 miliardë TRY, ose rreth 6.85 miliardë euro.

Në sigurimin e Jetës, primet e shkruara bruto u rritën me 9.66%, në terma vjetore, duke arritur në 12.33 miliardë TRY. Në sigurimin e Jo-Jetës, primet e shkruara bruto u rritën me 21.37% duke arritur në 58.26 miliardë TRY. Në fund të tremujorit të tretë 2021, linjat e biznesit me peshën më të madhe në totalin e primeve të shkruara bruto ishin: MTPL (22.68%), sigurimi i Jetës (17.47%), linjat e sigurimit të pronës (23.54%) dhe sigurimi i shëndetit (12.63%).

Shoqata e Sigurimeve të Turqisë ka 61 anëtarët aktivë që veprojnë si në tregun e Jetës dhe të Jo-Jetës.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al